



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 971/3 prot.

Tiranë më 23.07.2019

VENDIM

Nr. 22, datë 23.07.2019

PËR KONTROLLUESIN "ARJANI SH.P.K"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Arjani sh.p.k",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.191, datë 19.06.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Arjani sh.p.k" me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "Arjani sh.p.k" konstatoi se:

1. Kontrolluesi "Arjani sh.p.k" operon në sektorin e transportit rrugor të pasagjerëve nga viti 1996 e në vijim. Kategoritë e subjekteve të cilëve iu përpunohen të dhënat personale janë "punëmarrës", dhe "klientë".
2. Kontrolluesi, pasi ka marrë dijeni për ushtrimin e kontrollit administrativ, ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Por konstatohet nevoja e përditësimit në tërësi e formularit të njoftimit në përputhje me aktivitetin e ushtruar nga kontrolluesi.

Njoftimi është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore që duhet të plotësojë kontrolluesi përpara se të përpunojë të dhëna për herë të parë, pra që në momentin e fillimit të aktivitetit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9887 datë 10.03. 2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar: *“...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”*.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma “d” të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

3. Kontrolluesi, nuk ka hartuar një rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, pika 2/1: *“Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”*.

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe përdorimi i saj nga nëpunësit e tij, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe detyron punonjësit për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen nga keqpërdorimi dhe mënyrën e administrimit të të dhënave personale.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma “dh” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

4. Kontrolluesi nuk ka administruar deklaratat e konfidencialitetit të punonjësve. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar: *Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj..., dhe të Vendimit nr.06/2013 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*.

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin e formalizuar me titull “*Deklaratë Konfidencialiteti*”, dalë në zbatim të Vendimit nr. 6/2013 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”, merren përsipër të drejta dhe detyrime lidhur me mos transferimin në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar. Me nënshkrimin e një akti të tillë, synohet ndërgjegjësimi i plotë i

deklaruesit ndaj punëdhënësit për ruajtjen e të dhënave personale, të dhënat që i mëson për shkak të detyrës apo pozicionit që ka, si dhe paralajmërohet marrja e masave të menjëhershme administrative në rast të shkeljes së këtij standardi.

5. Konstatohet se kontrolluesi informon subjektet e të dhënave "vizitorë", mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) nëpërmjet tabelave informuese, sipas parashikimit të nenit 18, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar por ato nuk janë sipas modelit standard të miratuar me Udhëzimin nr.03/2010, të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjektet të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin e konstatimit, datë 24.06.2019, i cili u lexua dhe u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit nuk parashtroi pretendime.

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "Arjani sh.p.k" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, në datën 02.07.2019, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Kontrolluesi nuk është paraqitur në seancë dëgjimore.

Megjithatë, më datë 01.07.2019, kontrolluesi në rrugë elektronike ka dokumentuar rikuperimin e disa nga shkeljeve të konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, duke depozituar pranë Zyrës së Komisionerit:

- Kopje të tabelës informuese mbi sistemin e video-survejimit (CCTV), sipas standardit të miratuar me Udhëzimin nr.03/2010 të Komisionerit;
- Kopje të deklaratave të konfidencialitetit për punonjësit e shoqërisë;
- Formularin e "Njoftimit", mbi përpunimin e të dhënave personale.
- Rregullore e brendshme për ushtrimin e aktivitetit nga ana e kontrolluesit "Arjani Sh.p.k"

Konstatohet se kontrolluesi nuk ka depozituar një rregullore të mirëfilltë për "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", dhe për pasojë nuk ka dokumentuar plotësisht shkeljen administrative të nenit 27 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", pika 2/1: "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera".

Gjithashtu, konstatohet se Formulari i Njoftimit nuk është nënshkruar dhe vulosur sipas kërkesave formale të tij.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ të cilat konsistojnë në mos plotësimin e formularit të njoftimit, dhe rregullores specifike "Për mbrojtjen, përpunimin, dhe ruajtjen e të dhënave personale", në kuptim të nenit 39, pika 1, gërmat "d" dhe "dh" të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- d. "Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë";
- dh. "Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10.000 deri në 150.000 lekë".

Kontrolluesi "Arjani sh.p.k", në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar, është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, për kundërvajtjet e mësipërme dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara në lidhje me njoftimin dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave janë serioze. Rezulton nga të dhënat e regjistrit elektronik të shoqërive tregtare se "Arjani sh.p.k", ushtron aktivitetin tregtar nga viti 1996 e në vijim. Megjithatë, është marrë në konsideratë edhe fakti që pranë kontrolluesit nuk është kryer hetim administrativ i mëparshëm, bashkëpunimi i treguar me grupin e kontrollit si dhe reagimi për rikuperimin e disa shkeljeve, duke ndikuar në përcaktimin proporcional të masës së sanksionit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve, 21, 27, 29, 30, 39 pika 1 gërmat "d" dhe "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

#### **V E N D O S A:**

1. Dënimin e kontrolluesit "Arjani sh.p.k" me gjobë në vlerën 30.000 (tridhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Arjani sh.p.k", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
3. Kontrolluesi "Arjani sh.p.k", të hartojë rregulloren specifike "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", si dhe të plotësojë

Formularin e Njoftimit sipas standardeve, brenda 30 ditëve. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit

4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
5. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 23.07.2019

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

